



VENDIM

Nr.56 Date 25.08.2010

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE
VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË HERA SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.08.2010, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë HERA sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Se argumentat e shoqërisë janë të drejta dhe gjithashtu duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin Nr. 65, datë 22.09.2009 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve te vendosura nga ERE shoqërisë “HERA” sh.p.k.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA

Adresa: Blvd "Gjergj Fishta" Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al